

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI A

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Histori bërthamë

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11a	11b	12	13	14	15
Pikët								
Kërkesa	16	17a	17b	18a	18b	19	20	
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Lufta midis Spartës dhe Athinës njihet në histori me emrin: **1 pikë**
- A) Lufta Perse
 - B) Lufta e Peloponezit
 - C) Lufta e Mikenës
 - D) Lufta e Athinës
2. Kryqëzatat u filluan nga: **1 pikë**
- A) Kostandinopoja
 - B) Jeruzalemi
 - C) Kalifati
 - D) Papati
3. Pikëpamjet e Martin Luterit çuan në lindjen e: **1 pikë**
- A) protestanizmit
 - B) kristianizmit
 - C) katolicizmit
 - D) Judaizmit
4. Në pjesën më të madhe, Deklarata e Pavarësisë në SHBA (4 Korrik 1776), u hartua nga: **1 pikë**
- A) Xhorxh Uashington
 - B) Tomas Xheferson
 - C) Xhon Adams
 - D) Aleksandër Hamilton
5. Shkaku i fillimit të Luftës II Botërore ishte: **1 pikë**
- A) Rënia e Francës
 - B) Beteja e Britanisë
 - C) Krijimi i pushtetit të Musolinit
 - D) Pushtimi i Polonisë nga Hitleri
6. Integrimi i vendeve evropiane në BE synonte të: **1 pikë**
- A) Krijonte një forcë ushtarake të armatosur
 - B) Nxiste konkurrencën në tregun financiar
 - C) Nxiste bashkëpunimin ekonomik mes shteteve
 - D) Favorizonte politikën e nacionalizmit ekonomik
7. Shteti i Epirit arriti kulmin e vet si shtet, duke u shndërruar në një faktor të rëndësishëm të botës mesdhetare, gjatë qeverisjes së: **1 pikë**
- A) Aleksandrit molos
 - B) Tharypës
 - C) Alketës
 - D) Pirros
8. Principata që hodhi themelet e traditës shtetërore mesjetare ishte ajo e: **1 pikë**
- A) Arbrit
 - B) Balshajve
 - C) Topiajve
 - D) Muzakajve

- 9.** Skënderbeu e kaloi Lidhjen në një shtet të përqendruar për të: **1 pikë**
- A) forcuar pushtetin personal
 B) forcuar pozitën ndërkombëtare të vendit
 C) respektuar vullnetin e feudalëve shqiptarë
 D) eliminuar lëkundjet e feudalëve shqiptarë
- 10.** Vendimi i njohjes së Shqipërisë si: “*principatë autonome, sovrane e trashëgueshme*” nën garancinë e Fuqive të Mëdha u mor në: **1 pikë**
- A) Kongresin e Berlinit
 B) Traktatin e Shën Stefanit
 C) Konferencën e Ambasadorëve në Londër
 D) Traktatin e Fshehtë të Londrës
- 11. a)** Shpjegoni idenë e iluministit Monteskjë mbi ndarjen e pushteteve. **2 pikë**
- _____
- _____
- b)** Ku qëndron rëndësia e kësaj ideje? **1 pikë**
- _____
- 12.** Cilët ishin tre nga treguesit e krizës ekonomike botërore në vitet 1929-1933? **3 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- 13.** Shpjegoni konceptet: **3 pikë**
- a) Bizant: _____
- b) Metropol i Ilirikut: _____
- c) Asimilim: _____
- 14.** Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, dy superfuqitë luftuan për të krijuar epërsi ndaj njëra-tjetrës. Analizoni drejtimit në të cilat u shpreh konfrontimi midis tyre. **3 pikë**
- a) _____
- _____
- b) _____
- _____
- c) _____
- _____
- 15.** Renditni tre nga pikat e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (vitet '30 të shekullit XIX-28 nëntor1912). **3 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____

16. Argumentoni pse Shqipëria kishte tiparet e një republike presidenciale, pavarësisht se sipas Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë (1925) u shpall republikë parlamentare. **3 pikë**

- a) _____
 b) _____
 c) _____

17. Në bazë të analizës suaj lidhur me ngjarjet (konferencat, kongreset, luftimet etj.) në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, shkruani një nga objektivat e popullit shqiptar që u arrit dhe dy nga objektivat që nuk u arritën pas përfundimit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

a) *Objektivi që u arrit:* **1 pikë**

b) *Objektivat që nuk u arritën:* **2 pikë**

1. _____

2. _____

18. a) Cilat ishin vendet që e njohën dhe nuk e njohën qeverinë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore? **2 pikë**

Vendet që e njohën:

Vendet që nuk e njohën:

b) Përse u acaruan marrëdhëniet e SHBA-së dhe Anglisë me qeverinë e re shqiptare pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945? **1 pikë**

19. Analizoni tre nga shkaqet e krizës ekonomike në Shqipëri në vitet '80 të shek. XX. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

20. Duke krahasuar Statutin Organik të Shqipërisë dhe Statutin e Lushnjes, shkruani një të veçantë dhe dy të përbashkëta midis tyre. **3 pikë**

E veçanta:

Të përbashkëtat:
